



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1658/12 prot.

Datë 17.07.2025

V E N D I M
Nr. 919/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 846/2025, datë 03.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: Loti 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 *(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)* lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

Ankimues: Operatori ekonomik “O.E.S DISTRIMED” SHPK me NIPT K31520054N dhe adresë Blv: “Bajram Curri”, pallati “Kastrati”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, me adresë: Lagjia “Drita”, KP 8001, Burrel

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me NIPT L41629009A dhe adresë, Mëzez Rruga “Gani Domi”, pallati nr.1, shkalla 3, kati 1, apartament 46, Zonë kadastrale nr. 8180, numër pasurie 2/16+4-46, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 03.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 846/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 **(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)** lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 786/7 prot., datë 11.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1658/9 prot., datë 14.07.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, informon se ka zbatuar vendimin nr. 846/2025, datë 03.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 **(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)** lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar edhe procesverbalin për “Ri-vlerësimin e procedurës “E hapur e thjeshtuar-mallra”, prokurim elektronik, me objekt: “Loti nr. 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me nr. 859 prot., datë 10.07.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 786/7 prot., datë 11.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1658/9 prot., datë 14.07.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat, informon se ka zbatuar vendimin nr. 846/2025, datë 03.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 **(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)** lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar edhe procesverbalin për “Ri-vlerësimin e procedurës “E hapur e thjeshtuar-mallra”, prokurim elektronik, me objekt: “Loti nr. 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me nr. 859 prot., datë 10.07.2025.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 786/7 prot., datë 11.07.2025, procesverbalit për “Ri-vlerësimin e procedurës “E hapur e thjeshtuar-mallra”, prokurim elektronik, me objekt: “Loti nr. 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me nr. 859 prot., datë 10.07.2025, si dhe ng verifikimi në systemin e prokurimeve elektronike SPE rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin nr. 846/2025, datë 03.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka kryer të gjithë hapat proceduralë duke zbatuar vendimin nr. 846/2025, datë 03.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-49809-06-02-2025, me objekt: Loti 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale”, me fond limit 1,775,812.30 **(një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë tre)** lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

